



|               |       |                                                                                                   |          |
|---------------|-------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|----------|
|               |       | <b>ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS</b><br><b>KOSOVO DOCTORS CHAMBER</b><br><b>LEKARSKA KOMORA KOSOVA</b> |          |
| Nr. Prot.:    | Unit: | Nr. Prot.:                                                                                        | 18/2019  |
| Jedinit:      |       | Br. Prot.:                                                                                        |          |
| Nr. i faqeve: | -34-  | Data:                                                                                             | 19.02.19 |
| No. of pages: |       | Datum:                                                                                            |          |
| En. stranic:  |       | Prishtinë                                                                                         |          |

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RREGULLORE  
PËR  
EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Prishtinë, 2019

**KUVENDI I ODËS SË MJEKËVE TË KOSOVËS** në mbështetje të nenit 19, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.1 dhe në lidhje me nenin 9, paragrafit 1, me nënparagrafin 1.8 të Ligjit nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë, nenin 22, paragrafin 1, me nënparagrafin 1.1 dhe në lidhje me nenin 17, paragrafin 1, me nënparagrafin 1.8 të Statutit të Odës së Mjekëve të Republikës së Kosovës, miratuar në mbledhjen e datës 19 qershor 2018, e plotësuar dhe ndryshuar në mbledhjen e rregullt të datës 17 janar 2019, Kuvendi i OMK-së miraton këtë:

:

**RREGULLORE  
PËR  
EDUKIMIN E VAZHDUESHËM PROFESIONAL**  
(Teksti i spastruar me plotësime dhe ndryshime të miratuara sipas Vendimit nr. 14/2019 të  
Kuvendit të OMK-së, datë 17 janar 2019)

**KAPITULLI I – DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Me këtë rregullore përcaktohen kushtet, procedurat e Edukimit të Vazhdueshëm Profesional (në vazhdim EVP), akreditimi i planprogrameve të EVP-së, si dhe përkrahja financiare e shoqatave profesionale që organizojnë aktivitete të EVP-së.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Kjo Rregullore zbatohet ekskluzivisht për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe përkrahjen e aktiviteteve të EVP-së. Gjithashtu, procedurat e veçanta të parapara me këtë rregullore do të jenë të zbatueshme në procesin e rilicencimit të mjekëve.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Termat dhe akronimet e përdorura në tekstin e kësaj Rregulloreje, në zbatim të saj, kanë këto kuptime:
  - 1.1 **EVP** – nënkupton Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
  - 1.2 **Aktivitetet e EVP-së** – nënkupton ngjarjet e organizuara nga institucionet shëndetësore apo shoqatat profesionale që kanë karakter profesional dhe që organizohen me qëllim të ngritjes së vazhdueshme profesionale të mjekëve;

- 1.3 **Pikët kredituese** – nënkupton sistemin e vlerësimit të ngjarjeve që ndiqen nga profesionistët mjekësorë për qëllime të edukimit të vazhdueshëm profesional;
  - 1.4 **Oda** – nënkupton Odën e Mjekëve të Kosovës;
  - 1.5 **Komisioni për EVP** – nënkupton organin kompetent të Odës, i cili zbaton, mbikëqyr, planifikon dhe vlerëson aktivitetet e edukimit të vazhdueshëm profesional.
2. Termat dhe fjalitë që nuk janë të përfshira në përkufizimet sipas kuptimeve të dhëna në paragrafin 1 të këtij neni do të interpretohen sipas kuptimeve të përgjithshme gjuhësore dhe njohurive të përgjithshme shkencore dhe teknike.

#### **Neni 4**

##### **Përbërja dhe funksionimi i Komisionit për EVP**

1. Komisioni për EVP është organ i Odës, i cili në mënyrë ekskluzive zbaton kompetencën publike të EVP-së.
2. Komisioni për EVP përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve që janë të zgjedhur nga Kuvendi i Odës, në përputhje me dispozitat e Statutit të Odës dhe akteve normative të saj.
3. Puna dhe procedurat e vendimmarrjes së Komisionit të EVP-së janë të rregulluara me Rregulloren për Procedurat e Vendimmarrjes të Organeve të Odës.

#### **Neni 5**

##### **Ushtrimi i kompetencës së EVP-së**

1. Mbikëqyrjen dhe aranzhimin administrativ të EVP-së, në cilësi të kompetencës publike, e ushtron Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (EVP), si komision i përhershëm i Odës.
2. Komisioni për EVP në ushtrim të këtij funksioni publik do të ketë këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - 2.1 Zbatimi i procedurave të veçanta administrative për evidentimin e EVP-së;
  - 2.2 Krijimi i kushteve dhe stimulimi i sponsorizimit të aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.3 Zbatimi i buxhetit të Odës për përkrahjen e pjesëmarrjes në aktivitete të EVP-së nga anëtarët e Odës;
  - 2.4 Zbatimi i buxhetit të Odës për përkrahjen e organizimit të aktiviteteve të EVP-së nga institucionet shëndetësore dhe shoqatat profesionale mjekësore;
  - 2.5 Akreditimi i aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.6 Akreditimi i planeve vjetore dhe programeve për EVP;
  - 2.7 Akreditimin e pikëve të fituara nga anëtarët e Odës në angazhimin e tyre në procesin e EVP-së për nevojat e rilicencimit;
  - 2.8 Menaxhimin e regjistrit të aktiviteteve të EVP-së;
  - 2.9 Në bashkëpunim me Komisionin për Licencim, përcjell evidencën e profileve profesionale të anëtarëve të Odës në procesin e EVP-së; dhe

- 2.10 Kryen edhe funksione të tjera sipas nevojave për plotësimin e qëllimit të kompetencës publike për EVP, të bazuar në legjislacionin në fuqi dhe akteve të brendshme normative të Odës.
3. Komisioni për EVP bashkëpunon dhe në mënyrë të vazhdueshme kontakton me organet e tjera të Odës, në veçanti me Këshillin Drejtues, për çështjet që janë në interes të përgjithshëm të Odës.

## Neni 6

### Definicionet mbi aktivitetet e EVP-së

1. Me qëllim të unifikimit të terminologjisë së aktiviteteve të EVP-së dhe zbatimit të kësaj Rregulloreje, me dispozita të këtij neni disa termat kanë këtë kuptim:

1.1 **Kongresi** - është takim i një numri të madh të shkencëtarëve dhe ekspertëve të organizuar sipas një programi të përcaktuar për të diskutuar tema teknike dhe shkencore, për të vendosur kontakte personale, për vendimmarrje, etj. Punimet e prezantuara në kongres publikohen në përmbledhjen e punimeve, përmbledhjet e ekstrakteve apo në revistë profesionale. Karakteristikë e Kongresit është se zgjat disa ditë dhe përsëritet brenda periudhave të caktuara, dhe përbëhet nga një seri e ligjëratave (master class), prezantimeve poster, prezantimeve orale, trajnimeve profesionale (workshop), ekspozitave mjekësore etj. Karakteri kombëtar apo ndërkombëtar përcaktohet në bazë të pjesëmarrjes së ekspertëve dhe shkencëtarëve që janë të organizuar sipas një plani të përcaktuar me qëllim të ngritjes së njohurive teorike dhe praktike.

1.2 **Konferenca** – i referohet një takimi formal, ku pjesëmarrësit shkëmbejnë pikëpamjet e tyre mbi tema të ndryshme. Konferenca është një takim që është paraparë dhe përfshin konsultime dhe diskutime mbi një numër temash të caktuara. Konferenca mund të zgjasë disa ditë me diskutime formale që zhvillohen në ditët e zgjedhura dhe sipas rendit të ditës së konferencës.

1.3 **Simpoziumi** - është takim i kohëpaskohshëm shkencor - profesional i ekspertëve për të debatuar për një temë saktësisht të përcaktuar, mund të zgjasë një ose më shumë ditë dhe mund të përsëritet.

1.4 **Kurs pune** - paraqet një formë të përvetësimit të njohurive, aftësive të reja përmes ligjëratave teorike – praktike në grupe të vogla (deri në 50 pjesëmarrës). Pjesëmarrësit e kryejnë pjesën praktike të kursit në pacientë, fantom ose model, nën mbikëqyrjen e mentorit të tyre.

1.5 **Kursi demonstrativ** - është formë e përvetësimit të njohurive dhe aftësive të reja me anë të mësimit teorik dhe demonstrimit të procedurave të ndryshme klinike në pacientët, fantom apo model, nga ana e mentorit të tyre.

1.6 **Kursi teorik** - është njoftimi me gjetjet e reja në fushën e mjekësisë, ekskluzivisht përmes ligjëratave.

1.7 **Seminari** - është edukim i vazhdueshëm, në kuadër të të cilit shtjellohet në aspektin teorik një temë e caktuar, ku së paku 30% e kohëzgjatjes së seminarit i kushtohet diskutimit interaktiv në mes ligjëruesit dhe pjesëmarrësit.

2. Për nevojat e vlerësimit të drejtë të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm profesional, në nënparagrafët vijues, aktivitetet e edukimit specifik të lëmenjve gjegjësisht kanë këtë kuptim:

2.1 Edukimi i ngushtë/specifik nga lëmi i caktuar mjekësor dhe/apo shëndetësor është edukim ku pjesëmarrësit arrijnë njohuri dhe shkathtësi nga lëmenj të caktuar (p.sh. diagnostikimi dhe ndërhyrja në ndonjë lëmi të caktuar specialiste). Ky edukim ndahet në tri kategori, të cilat duhet të futen në shtojcën II të aktiviteteve.

2.2 Edukimi i ngushtë/specifik i kategorisë I, me qasje bashkëkohore që trajton një lëmë të caktuar (p.sh. diagnostikimi dhe veprimet e marra në lëmenj të caktuar specialistikë), me të dhënat më reja nga literatura botërore. Ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të certifikuar të lëmit të ngushtë/specifik. Ky lloj i edukimit duhet të ketë materialin e shkruar paraprakisht, si dhe materiale të shkruara konsiderohen edhe materialet e tjera në formë elektronike, si incizimet për diagnostikim, procedurat terapeutike/rehabilituese dhe të ngjashme.

Kohëzgjatja e edukimit të ngushtë/specifik nuk mund të ketë më pak se 80 orë (45 minuta mësimore-1 orë) dhe obliguese është mbajtja e provimit teorik dhe praktik.

2.3 Edukimi i ngushtë/specifik i kategorisë II, me qasje bashkëkohore që trajton një lëmë të caktuar (p.sh. diagnostikimi dhe veprimet e marra në lëmenj të caktuar specialistikë), bëhet me të dhënat më të reja nga literatura botërore. Ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të certifikuar të lëmit të ngushtë/specifik. Ky lloj i edukimit duhet të ketë materialin e shkruar paraprakisht, si dhe materiale të shkruara konsiderohen edhe materialet e tjera në formë elektronike, si incizimet për diagnostikim, procedurat terapeutike/rehabilituese dhe të ngjashme.

Kohëzgjatja e edukimit të ngushtë/specifik nuk mund të ketë më pak se 60 orë (45 minuta mësimore-1 orë) dhe obliguese është mbajtja e provimit teorik dhe praktik.

2.4 Edukimi i ngushtë/specifik i kategorisë III, me qasje bashkëkohore që trajton një lëmë të caktuar (p.sh. diagnostikimi dhe veprimet e marra në lëmenj të caktuar specialistikë), bëhet me të dhënat më të reja nga literatura botërore. Ligjëruesit duhet të jenë ekspertë të certifikuar të lëmit të ngushtë/specifik. Ky lloj i edukimit duhet të ketë materialin e shkruar paraprakisht, si dhe materiale të shkruara konsiderohen edhe materialet e tjera në formë elektronike, si incizimet për diagnostikim, procedurat terapeutike/rehabilituese dhe të ngjashme.

Kohëzgjatja e edukimit të ngushtë/specifik nuk mund të ketë më pak se 35 orë (45 minuta mësimore-1 orë) dhe të dëshmohet aftësia e fituar gjatë edukimit të ngushtë/specifik.

2.5 Komisioni me rastin e vlerësimit të aktiviteteve të EVP-së do të shqyrtojë edhe certifikatat e fituara në bazë të programeve dhe trajnimeve të ndjekura në internet, i ashtuquajturë edukim në distancë. Kusht për t'u vlerësuar programi i tillë i EVP-së është që ai të jetë kredibil dhe të jetë i akredituar nga vendi amë, nga ku ofrohet ndjekja e tij.

## Neni 7

### Aktivitetet akademike dhe shkencore në kuadër të EVP-së

1. Mjekët gjatë formësimit të tyre profesional marrin pjesë në kurrikulat akademike dhe profesionale me qëllim të ngritjes së njohurive shkencore dhe profesionale.
2. Aktivitetet e tilla përfshijnë, por nuk kufizohen në:
  - 2.1 Edukimin specialistik;
  - 2.2 Studimet e doktoratës;
  - 2.3 Studimet pasdiplomike në programin master;
  - 2.4 Studimet profesionale dhe shkencore;
  - 2.5 Kurset për aftësim profesional (ligjërata);
  - 2.6 Qëndrimi studimor aktiv jashtë shtetit;
  - 2.7 Publikimi i punimeve në revistat profesionale dhe shkencore;
  - 2.8 Publikimi i librave dhe doracakëve nga mjekësia dhe format e tjera; dhe
  - 2.9 Takimet dhe format e tjera nga Plan i vjetor i programit të aftësimit profesional.
3. Aktivitetet nga paragrafi 2 i këtij neni paraqesin po ashtu aktivitete në kuadër të EVP-së, që vlerësohen nga Komisioni për EVP gjatë shqyrtimit të lëndëve të parashtruara.

## **KAPITULLI II – AKREDITIMI I PLANEVE DHE AKTIVITETEVE**

### **Neni 8**

#### **Akreditimi i planeve vjetore dhe programeve**

1. Institucionet shëndetësore dhe shoqatat profesionale janë të obliguara që me qëllim të organizimit të aktiviteteve të ndryshme të EVP-së të përgatisin planet vjetore dhe programet që do të organizohen në bazë vjetore.
2. Plan i vjetor dhe programi për EVP duhet të përgatitet nga subjekti, i cili parashtrohet aplikacionin për akreditim të planit vjetor apo programit, duke detajuar përmbajtjen e aktiviteteve, qëllimin dhe dobinë profesionale të tyre në raport me pjesëmarrjen e mjekëve në aktivitete të tilla.
3. Plan i dhe programi i EVP-se krahas të dhënave që janë përcaktuar me paragrafin 2 të këtij neni, ndër të tjera, duhet të përmbajë:
  - 3.1 Vendin dhe kohën e ngjarjeve;
  - 3.2 Temën dhe ligjëruesit në ngjarje; dhe
  - 3.3 Mënyrën e ligjërimit.

### **Neni 9**

#### **Subjektet e autorizuar për akreditim të planeve vjetore, programeve dhe aktiviteteve të EVP-së**

1. Në cilësinë e subjekteve të autorizuar për procesin e akreditimit të planeve vjetore, programeve dhe aktiviteteve të EVP-së janë:
  - 1.1 Institucionet shëndetësore të tri niveleve të kujdesit shëndetësor;
  - 1.2 Shoqatat profesionale të mjekëve;
  - 1.3 Institucionet e arsimit të lartë të akredituara nga organi kompetent i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;

- 1.4 Subjektet biznesore që kanë veprimtarinë e regjistruar të ndërlidhur me fushën e mjekësisë; dhe
- 1.5 Personat të tjerë fizikë dhe juridikë me kusht që të jenë të licencuar për aftësim profesional.
2. Oda është po ashtu subjekt i autorizuar që bart aftësi juridike për të organizuar aktivitete për EVP-në.
3. Të paktën 1 (një) herë në vit, Oda do të organizojë aktivitetet për qëllim të EVP-së. Me këtë rast Oda mund të organizojë aktivitetin e tillë në bashkëpunim me ndonjërin nga subjektet e autorizuar sipas paragrafit 1 të këtij neni, në përjashtim me organizata fitimprurëse.
4. Pjesëmarrja në aktivitete, që janë të organizuara nga Oda, mund të kufizohet në pjesëmarrjen vetëm të anëtarësisë së Odës.

### **Neni 10**

#### **Procedura e akreditimit të planit vjetor dhe programit të EVP-së**

1. Procedura për akreditimin e planit vjetor dhe programit inicohet me dorëzimin e aplikacionit që i është bashkëngjitur Shtojcës I (Formulari nr. 2 dhe formulari nr. 4), i cili plotësohet nga personi i autorizuar i subjektit që parashtron aplikacionin për akreditim.
2. Aplikacioni për akreditim të planit vjetor dhe programeve duhet parashtruar nga subjekte të interesuara jo më vonë se data e 15 nëntorit të vitit vijues.
3. Komisioni për EVP shqyrton aplikacionin me dokumentacionin përkatës dhe në rast të akreditimit të planit dhe programit lëshon certifikatë me të cilën akreditohen plani dhe programi i EVP-së.
4. Në rast të refuzimit të akreditimit të planit vjetor dhe programit, subjektet e interesuara kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Këshillin Drejtues të Odës në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të vendimit me të cilin është refuzuar akreditimi i planit vjetor dhe programit.
5. Me rastin e parashtrimit të aplikacionit për akreditim, palët janë të obliguara që në emër të taksës për iniciimin e procedurës për akreditim të paguajnë taksën administrative në shumë të përcaktuar sipas vendimit të organit kompetent të Odës.
6. Me rastin e akreditimit të planit vjetor dhe programit, palët janë të obliguara që të paguajnë tarifën për akreditim në lartësi të caktuar sipas kriterëve të caktuara nga organi kompetent i Odës.

## **Neni 11**

### **Dokumentet e nevojshme për akreditim të planit vjetor dhe programit**

1. Aplikuesit për akreditim të planit vjetor dhe programit, krahas aplikacionit të dorëzuar, janë të obliguar që aplikacionit t'i bashkëngjitin dokumentet si në vijim:
  - 1.1 Programin e hollësishëm të aktivitetit, duke përfshirë përcaktimin e objektivave, përmbajtjes, metodologjisë, orarit dhe vendit të mbajtjes;
  - 1.2 Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
  - 1.3 Certifikatën e numrit fiskal;
  - 1.4 Në rastet e organizimit të kongreseve, konferencave dhe simpoziumeve, aplikuesit duhet të parashtojnë raportin e këshillit shkencor mbi punimet e pranuar, të cilat do të prezantohen në evenimentin e tillë.
2. Dështimi për të plotësuar dokumentacionin e përcaktuar sipas paragrafit 1 të këtij neni paraqet bazë për refuzimin e akreditimit të planit vjetor dhe programit.

## **Neni 12**

### **Mbikëqyrja e planit vjetor dhe e programeve**

1. Komisioni për EVP do të mbikëqyrë zbatimin e planit vjetor dhe të programeve që janë akredituar.
2. Komisioni për EVP do të mbikëqyrë zbatimin e planit të akredituar përmes mbikëqyrjes së drejtpërdrejtë nga personi i autorizuar nga Komisioni, apo edhe me kontaktet e drejtpërdrejta të Komisionit me përfaqësuesin e subjektit që zbaton planin dhe programin e akredituar.
3. Në rast se subjekti, i cili zbaton planin vjetor dhe programin e akredituar, nuk u përmbahet përsëkrimeve për të cilat është lëshuar certifikata për akreditim, Komisioni do të revokojë certifikatën dhe aktivitetet e mbetura konsiderohen si të paakredituara.
4. Komisioni me rastin e revokimit të certifikatës, subjektit mund t'i shqiptojë masë ndaluese me ndalim të akreditimit deri në 3 vjetët e ardhshëm.
5. Revokimi i certifikatës do të evidentohet në regjistrin e aktiviteteve të EVP-së.
6. Aktivitetet e vijura deri në revokim të certifikatës do të konsiderohen si të akredituara.

## **Neni 13**

### **Akreditimi i aktiviteteve**

1. Subjektet e autorizuara mund të parashtojnë kërkesë për akreditim të aktivitetit të EVP-së në Komisionin për EVP.

2. Për akreditim të aktivitetit, subjekti i autorizuar duhet të parashtojë në Komisionin për EVP aplikacionin e veçantë që gjendet në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje.
3. Subjekti i autorizuar krahas aplikacionit duhet të bashkëngjitë dokumentacionin e njëjtë sipas nenit 11 të kësaj Rregulloreje, si dhe përshkrimin e detajuar të aktivitetit.
4. Afati për parashtrimin e aplikacionit për akreditim të aktivitetit është 30 (tridhjetë)ditë para mbajtjes së aktivitetit.
5. Komisioni për EVP me rastin e akreditimit të aktivitetit do të lëshojë certifikatë akredituese në të cilën do të vlerësojë llojin e aktivitetit dhe pikët kredituese që do të kreditohen për pjesëmarrësit.
6. Organizatori i aktivitetit është i obliguar që me rastin e përfundimit të aktivitetit t'u lëshojë certifikata pjesëmarrësve. Në certifikatë domosdo duhet të vihet logoja e Odës, autoriteti i cili e ka akredituar evenimentin dhe pikët kredituese që i janë njohur aktivitetit.
7. Subjekti të cilit i lëshohet certifikata është i obliguar që të paguajë tarifën për akreditim sipas lartësisë së përcaktuar me vendim të organit kompetent.
8. Afati për tërheqjen e certifikatës dhe pagesës së taksës administrative për akreditim program/aktiviteti është 8 ditë, nga dita e njoftimit për vendimin e marrë nga Komisioni për EVP, përmes zyrtarit administrativ të Komisionit.

#### **Neni 14** **Gjobat ndëshkuese**

1. Në rastet kur subjektet gjatë zbatimit të aktivitetit apo programit të akredituar të EVP-së nuk i respektojnë kriteret dhe përmbajtjen e akredituar të aktivitetit apo programit, Komisioni do të shqiptojë sanksionin administrativ në shumë minimale prej 50% të taksës së paguar deri në 5.000.00 €.
2. Ndaj vendimit me të cilin Komisioni shqipton sanksionin administrativ, palët e pakënaqura mund të parashtojnë ankesë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të vendimit nga ana e palës. Ankesa e tillë parashtrohet në Këshillin Drejtues të Odës.

### **KAPITULLI III – AFTËSIMI PROFESIONAL**

#### **Neni 15** **Obligimi i mjekëve për aftësim të vazhdueshëm**

1. Anëtar i Odës, respektivisht mjeku, është i obliguar që t'i nënshtrohet edukimit të vazhdueshëm profesional në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e kujdesit mjekësor dhe të plotësojë kushtet për rilicencim.

2. Të gjithë mjekët që janë specializantë në lëmenj përkatës nuk obligohen në grumbullimin e 100 pikëve për procedurën e rilicencimit, kjo vlen vetëm gjatë periudhës së rregullt të edukimit specialistik.
3. Çdo ndërprerje e edukimit specialistik dhe EVP-së me arsye të dëshmuar, si pushimi i lehonisë, sëmundje të ndryshme, si dhe arsye të tjera, lirohen nga obligimi i grumbullimit të pikëve për periudhë kohore deri në një (1) vit. Për periudhën 6-mujore lirohen për 10 pikë, ndërsa për periudhën një (1)-vjeçare lirohen për 20 pikë.
4. Aplikuesit që u takojnë kategorive sipas paragrafit 3 të këtij neni obligohen që të dorëzojnë në Komisionin për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional – OMK kërkesën për lirim nga grumbullimi i pikëve së bashku me dokumentacionin, i cili dëshmon arsyetimin e pamundësisë së grumbullimit të pikëve që ka qëllim edukimin e vazhdueshëm profesional.
5. Të gjithë aplikuesit, të cilët pas shqyrtimit të lëndës për grumbullimin e 100-pikëshit me qëllim të rilicencimit kanë arritur të grumbullojnë së paku 95 pikë, në afat prej pesë (5) ditësh mund të paraqesin kërkesë në Komision me arsyetimin e mungesës së pikëve, që rezulton me rishqyrtimin e vendimit të Komisionit të EVP-së.

#### **Neni 16** **Portofoli personal i EVP-së**

1. Anëtari i Odës është i obliguar që brenda 5 (pesë) vjetëve të grumbullojë në total 100 (njëqind) pikë për pjesëmarrje në aktivitetet e EVP-së.
2. Valorizimi i pikëve kredituese është kompetencë ekskluzive e Komisionit për EVP. Valorizimi i pikëve për pjesëmarrje të aktiviteteve do të bëhet sipas Shtojcës II, në të cilën janë përcaktuar pikët kredituese për secilin lloj të aktivitetit.
3. Me rastin e valorizimit të pikëve, Komisioni për EVP lëshon certifikatë në të cilën konstaton valorizimin e pikëve nga aktiviteti.
4. Pala e pakënaqur me valorizimin e bërë nga Komisioni për EVP ka të drejtë ankese në Këshillin Drejtues në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimin të certifikatës për valorizim.

#### **Neni 17** **Mënyra e llogaritjes së pikëve**

1. Anëtari i Odës është i obliguar të marrë pjesë në aktivitete të edukimit profesional në mënyrë që çdo vit të fitojë së paku 15 (pesëmbëdhjetë) pikë dhe maksimum 25 (njëzet e pesë) pikë, sipas listës së pikëve, duke e llogaritur nga data e lëshimit të licencës së fundit për punë.
2. Nëse një anëtar i Odës me pjesëmarrjen në edukim të vazhdueshëm profesional në 1 (një) vit arrin më shumë se 25 (njëzet e pesë) pikë në bazë të listës së pikëve, ato pikë nuk do t'i njihen në vitin e ardhshëm sipas mënyrës së paraparë.

## **Neni 18**

### **Inicimi i procedurës**

1. Anëtar i Odës inicion procedurën e valorizimit të portofolit personal përmes parashtrimit të aplikacionit që është përcaktuar në Shtojcën I (Formulari nr. 3) të kësaj Rregulloreje.
2. Aplikacionit të plotësuar me të dhënat relevante dhe të deklaratës nën betim duhet t'i bashkëngjiten edhe dokumentacionet përcjellëse, siç janë:
  - 2.1 Kopja e letërnjoftimit;
  - 2.2 Kopja e licencës së punës;
  - 2.3 Kopja e provimit specialistik, në rast se aplikuesi ka statusin profesional të tillë;
  - 2.4 Kopjet e certifikatave të aktiviteteve që ka marrë pjesë dhe materiali tjetër që dëshmon aktivitetin e tij profesional dhe shkencor, i cili mund të jetë objekt i vlerësimit.
3. Aplikuesi me rastin e dorëzimit të aplikacionit me dokumentacionin përcjellës duhet të paguajë taksën administrative për inicim të procedurës në Komisionin për EVP.

## **KAPITULLI IV – PËRKRAHJA PËR ORGANIZIM DHE PJESËMARRJE NË EVP**

### **Neni 19**

#### **Subjektet me të drejtë të përfitimit të përkrahjes**

1. Në përputhje me ndarjen buxhetore dhe kriteret e përcaktuara me Shtojcën III të kësaj Rregulloreje, subjektet që kanë të drejtë për të aplikuar për përkrahje në organizim të aktiviteteve të EVP-së janë:
  - 1.1 Shoqatat profesionale mjekësore; dhe
  - 1.2 Mjekët anëtarë të Odës (ekipe me së paku 2 mjek), vetëm pas marrveshjeve paraprake me institucionet shëndetësore për bashkëfinancim.
2. Mangësia e autorizimit subjektiv të aplikuesve, sipas kësaj Rregulloreje, përjashton në cilëndo rrethanë përfitimin e përkrahjes për pjesëmarrje apo organizim të aktiviteteve të EVP-së.

### **Neni 20**

#### **Inicimi i procedurës për përkrahje**

1. Procedura për përkrahje në organizim të aktiviteteve të EVP-së inicohet me parashtrimin e aplikacioneve të veçanta që janë të përcaktuara në Shtojcën I të kësaj Rregulloreje.
2. Aplikacioni i plotësuar duhet t'i përmbajë të gjitha të dhënat personale dhe të dhënat mbi shoqatën, e cila aplikon për përkrahje në organizim të aktiviteteve të EVP-së.

## **Neni 21**

### **Dokumentacioni për përkrahje dhe organizim të aktiviteteve të EVP-së**

1. Shoqatat profesionale që shprehin interesimin për përkrahje të organizimit të aktiviteteve të EVP-së, krahas të dhënave të përgjithshme që janë të përcaktuara në formularin nr. 1 të Shtojcës I të kësaj Rregulloreje, janë të obliguara që aplikacionit t'ia bashkëngjitin dokumentet si në vijim:
  - 1.1 Programin e hollësishëm të aktivitetit, duke përfshirë objektivat, përmbajtjen, metodologjinë dhe çështje të tjera që janë të rëndësishme për të përshkruar aktivitetin;
  - 1.2 Buxhetin e planifikuar të aktivitetit;
  - 1.3 Dobitë e pritura për pjesëmarrësit e aktivitetit;
  - 1.4 Relevanca për politikat e përgjithshme shëndetësore; dhe
  - 1.5 Termat e referencës, të cilat përshkruhen në aplikacion.
2. Aplikacioni me dokumentacionin vijues për përkrahje të aktiviteteve duhet të parashtrohen në Komisionin për EVP jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para datës së planifikuar të ngjarjes.
3. Komisioni për EVP do të shqyrtojë aplikacionin dhe dokumentet e bashkëngjitura duke u bazuar në kriteret që janë të përfshira në Shtojcën nr. III të kësaj Rregulloreje, përfshirë këtu edhe shumën e aprovuar të bazuar në lartësinë e lejuar sipas llojit të aktivitetit.
4. Komisioni për EVP nxjerr vendim të veçantë me të cilin vendos lidhur me aplikacionin e proceduar pranë tij.
5. Palët e pakënaqura me vendimin sipas paragrafit 4 të këtij neni kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të vendimit në formë të shkruar.

## **Neni 22**

### **Detyrimet e organizatorit përfitues për aktivitet të EVP-së dhe mbikëqyrja**

1. Shoqata profesionale që ka përfituar nga financimi i Odës për aktivitet të EVP-së është e obliguar që t'u përmbahet programit dhe përmbajtjes së aktivitetit, ashtu siç është përshkruar në aplikacion dhe dokumentacionin e dorëzuar në Komision të EVP-së.
2. Shoqata profesionale është e obliguar që të dorëzojë në Komisionin për EVP raportin e detajuar në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e mbajtjes së ngjarjes, në të cilin përfshihet arsyetimi i bazuar në dokumente financiare mbi shfrytëzimin e buxhetit të planifikuar për aktivitet.
